



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

**VENDIM**

**Nr. 100 dt. 27.10.2014**

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 27.10.2014, pasi shqyrtoi kërkesën për rilicensim në fushën e restaurimit për ark. Kliti Kallamata,

**VENDOSI:**

1. Pajisjen e ark. Kliti Kallamata me licensë restaurimi personale profesionale në fushën e restaurimeve për kategorinë A, me nënkategoritë A/1, A/2, A/3, A/4, sipas rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit”
2. T’i propozojë Ministrit të Kulturës, pajisjen e ark. Kliti Kallamata me licensë restaurimi personale profesionale në fushën e restaurimeve për kategorinë A, me nënkategoritë A/1, A/2, A/3, A/4.
3. T’i propozojë Ministrit të Kulturës, revokimin e URDHRIT nr. 284, datë 15.10.2014, “Për pezullimin e licensës së shoqërisë “E SHKUARA PËR TË ARDHMEN” shpk” me drejtues teknik dhe ligjor ark. Kliti Kallamata.
4. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e tij.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**MIRELA KUMBARO FURXHI**

**SEKRETAR I KKR**

**ARTA DOLLANI**